

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 31 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot kemi për të diskutuar një akt normativ, i cili nuk është produkt i kësaj qeverie si pasojë e përgjegjshmërisë së saj dhe ndjeshmërisë për t'iu gjendur pranë qytetarëve me paketa masash, por për shkak të protestës së qytetarëve, që me të drejtë mbushën sheshet, pasi çmimi i naftës kapi nivele rekord dhe çmimet e produkteve të shportës u rritën ndjeshëm brenda një kohe shumë të shkurtër. Kjo gjendje e vështirë ekonomike, pa dyshim e rënduar akoma më shumë prej efekteve të luftës që po zhvillohet në Ukrainë, kërkon përgjegjshmëri dhe transparencë në qeverisjen e vendit. Mirëpo jo vetëm transparencë nuk ka, por ky akt normativ ka vetëm një qëllim: t'iu hedhë hi syve shqiptarëve me pseudomasa që nuk lehtësojnë dhe nuk janë të mjaftueshme për ekonominë familjare të shqiptarëve, që sot po përballen me çmime 30% më të shtrenjta dhe që pritet të rriten ende. Por çfarë është më e keqja, arsimit në Shqipëri sot merr një goditje të rëndë.

Sot kjo qeveri e inceneratorëve na sjell për miratim një akt normativ që i heq plot 15 milionë dollarë arsimit, i cili ndodhet aktualisht në kushte tejet të vështira. Qeveria që nuk rresht së paguari miliona euro nga taksat tona për inceneratorët dhe edhe kur ato janë nën sekuestro dhe bosët e tyre në arrati edhe tani që janë nën sekuestro, qeveria që paguan miliona euro për inceneratorë që nuk ekzistojnë, heq paratë nga shkollimi fëmijëve, të rinjve dhe studentëve shqiptarë. Për sektorin e arsimit qeveria ka parashikuar shkurtime me mbi 15 milionë dollarë ose 3,6% e parashikimit në buxhetin fillestar; shkurtime për shpenzimet për arsimin universitar me mbi 5,5%, ose 600 milionë lekë. Fondet për arsimin bazë u reduktuan me 3% ose 756 milionë lekë dhe fondet për arsimin e mesëm u shkurtuan 3% ose 278 milionë lekë.

Arsimi është i vetmi sektor që nuk mund të sakrifkohet në emër të lehtësimit të çfarëdolloj krize. Ndaj ndërprisni pagesat e inceneratorëve, të koncensioneve dhe jo buxhetin e arsimit! Shkurtimi i fondeve në arsim është dëmtim me vetëdije i së ardhmes. Sot buxheti i arsimit, i parashikuar në buxhetin e 2022, është 3,51% e PPB-së, shumë larg mesatares së rajonit që është 5% e PPB-së apo premtimit të kësaj maxhorance. Buxheti i arsimit është në masë të konsiderueshme më i ulëti dhe kësaj i shtohet dhe ky shkurtim i fundit. Ndërsa hartohet buxheti i 2022-shit, ne kemi kërkuar në mënyrë specifike rritjen me 5 miliardë lekë të buxhetit për arsimin, pra mbi 5 miliardë shtesë në mënyrë që të kapë mesataren e rajonit. Por kjo jo vetëm që nuk u bë, por arsimit i reduktohet buxheti në emër të krizës energjetike, e cila do të lehtësohet thjesht me anulimin e një koncesioni ose ndalimin e pagesave për inceneratorët fantazmë. Por kur ndodh ky shkurtim?

Ky shkurtim vjen në një moment kur qeveria po pasurohet, ndërsa qytetarët varfërohen për shkak të rritjes së çmimeve. Vetëm për 2 muajt e parë të vitit janë mbledhur 180 milionë dollarë më shumë të

ardhura. Kjo vjen si pasojë e të ardhurave të realizuara nga TVSH-ja për shkak të rritjes së çmimeve. Atëherë, lind pyetja pse shkurtohet buxheti i arsimit? Sepse arsimi dhe të rinjtë nuk janë prioritet për këtë qeveri. Ky akt normativ që prek buxhetin më të rëndësishëm, arsimin, dhe nuk prek pagesat e inceneratorëve ose të koncensioneve tregon qartë se kjo qeveri nuk e ka pasur kurrë prioritet këtë sektor, as të rinjtë që sot po detyrohen të lënë vendin e tyre, sepse nuk kanë shpresë dhe as mundësi punësimi e jetese me dinjitet në vendin e tyre. Kjo qeveri jo vetëm nuk mban përgjegjësi për krimin shtetëror të inceneratorëve, që i kanë vjedhur miliona euro buxhetit të shtetit dhe qytetarëve më të varfër në rajon, ku 40% e tyre jetojnë nën 5,5 dollarë në ditë dhe tregoi edhe një herë se nuk sakrifikon te klientët e saj, por zgjedh të sakrifikojë të ardhmen e fëmijëve tanë.

Qeveritë e përgjegjshme shihen në kohë krizash. Qeveritë e përgjegjshme reagojnë në kohë me masa në ndihmë të shtresave në nevojë e grupeve vulnerabël, nuk prekin buxhetin e arsimit, shëndetësisë dhe emergjencat civile, por kjo qeveri ka vetëm një hall: inceneratorët, koncesionet dhe oligarkët që ka përreth. Arsimi është dhe do të jetë për ne prioritet kombëtar si i vetmi mjet që kemi për të formuar një brez të aftë, për të zhvilluar ekonominë e vendit dhe për të ndaluar shpopullimin. Ndaj unë refuzoj të miratoj këtë akt normativ që shkurton buxhetin e arsimit dhe nuk ndërpret milionat që shkojnë sot për inceneratorë që nuk ekzistojnë, në një mega aferë korruptive dhe vjedhje të pastër të taksave të qytetarëve, që sot nuk po arrijnë të përballojnë dot çmimet e larta dhe koston e jetesës, sepse fatkeqësisht drejtohen nga një qeveri e korruptuar dhe e papërgjegjshme edhe në kohë krize. Faleminderit!